

DORACAK
PËR TË RINJTË
PËR REALIZIMIN
E SË DREJTËS
PËR QASJE TË LIRË
NË INFORMACIONE ME
KARAKTER PUBLIK



Botues:
Asociacioni për Iniciativa Demokratike

Redaktor:
Lulzim Haziri

Autor:
Risto Karajkov

Përkthimi në gjuhën shqipe:
Agim Mustafai

Dizajni dhe shtypi
Kontura SHPK

Tirazhi:
100 kopje

Ky doracak është përgatitur nga Asociacioni për iniciativa demokratike dhe Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata publike me mbështetjen e popullit Amerikan përmes Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

DORACAK PËR TË RINJTË PËR REALIZIMIN E SË DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK

Gostivar
2022



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN



Republika e Maqedonisë së Veriut

AGJENCIA E MBROJTJES TË SË
DREJTËS PËR QASJE TË LIRË NË
INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK

AD

Përmbajtja:

Lista e shkurtesave	1
Lista e grafikoneve	1
1. Hyrje	2
2. Ndërtimi i kulturës së transparencës dhe llogaridhënies	3
3. Ligji për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik (LQLIKP)	6
4. Kush është i obliguar t’ju përgjigjet kërkesave për QLIKP?	6
5. Informacione me karakter publik	8
5.1 Çka mund të kërkohet si informacion?	10
5.2 Personi zyrtar: Nga kush kërkohet informacioni?	10
5.3 Përjashtime nga DQLIKP	11
5.4 Çka është interesi publik?	12
5.5 Obligimi për të publikuar informacione	14
6. Si të parashtroni një kërkesë për QLIKP?	15
6.1 Çka nëse poseduesi nuk i përgjigjet kërkesës?	15
7. Konkluzione	17
8. Programe trajnimi për të rinjtë për të njohjen dhe shfrytëzimin e DQLIKP	18
8.1 Moduli 1	18
8.2 Moduli 2	19
8.3 Moduli 3	20
8.4 Moduli 4	20
9. Referenca	21

Lista e shkurtesave

LQLIPK	Ligji për Qasje të Lirë deri në Informatat me Karakter Publik
KDF	Konventa për të drejtat e fëmijëve
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
QLIKP	Qasje e lirë në informatat me karakter publik
OSHQ	Organizatë e Shoqërisë Civile
AQLIKP	Agjencia për qasje të lirë në informacione me karakter publik
PDU	Plani i Detajuar Urbanistik
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
NP	Ndërmarrje Publike

Lista e grafikoneve

Grafikoni 1.	Lista e poseduesve të informacionit
Grafikoni 2.	Shembull i kërkesës për QLIKP
Grafikoni 3.	Lista e poseduesve. Kontakt i personit zyrtar
Grafikoni 4.	Udhëzime dhe formulari i ankesës

1. Hyrje

Qëllimi i këtij doracakut është t'i informojë të rinjtë për synimet dhe përfitimet bazë nga Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik¹ (LQLIKP), si dhe t'i udhëzojë ata se si të ushtrojnë të drejtën për qasje deri në informacione me karakter publik. Doracakut i paraqet çështjet kryesore të ligjit në mënyrë të thjeshtë dhe e udhëzon lexuesin hap pas hapi me proceset që ai i rregullon.

Doracakut është burim i rëndësishëm për edukimin në arsimin joformal mbi temat që lidhen me të drejtat e njeriut, demokracinë dhe rininë aktive. Në fund të doracakut mund të gjeni aktivitete praktike për të ndihmuar të rinjtë të kuptojnë më mirë të drejtën e qasjes deri në informacione.

E drejta për informim konsiderohet pjesë e korpusit bazë të të drejtave të njeriut. Dokumentet themelore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nuk parashikojnë shprehimisht të drejtën e informimit, por sot pranohet gjerësisht se kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me lirinë e fjalës. Konteksti qëndron në atë se e drejta për informim është një parakusht për lirinë e fjalës.² Në vitin 2009, Këshilli i Evropës e rregulloi drejtpërdrejt këtë të drejtë me Konventën për Qasjen në Dokumentet Zyrtare (e njohur më mirë si Konventa e Tromsø)³. Konventa hyri në fuqi në vitin 2020 pasi u ratifikua nga një numër i mjaftueshëm shtetesh dhe është një dokument ndërkombëtar ligjërishit i detyrueshëm për të drejtën e qasjes në informacionet me karakter publik⁴. Për më tepër, e drejta për informim është një komponent thelbësor i konventave dhe standardeve të shumta kundër korrupsionit.

Në dy dekadat e fundit, shumë vende mbarë botës kanë miratuar ligje për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.⁵

E drejta për të qenë i informuar konsiderohet si pjesë e korpusit të të drejtave të fëmijëve në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve (KDF).⁶ KDF i përcakton si fëmijë personat deri në 18 vjeç, që padyshim ka të bëjë me personave që tashmë konsiderohen si të rinj.

E drejta për qasje të lirë deri në informacione është përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV). Neni 16, paragrafi 3 i Kushtetutës “garanton qasjen e lirë deri në informacione, lirinë e marrjes dhe transmetimit të informacionit.”⁷

Në vitin 2020, Republika e Maqedonisë së Veriut miratoi Ligj për pjesëmarrje të të rinjve dhe politika rinore⁸, i cili e potencon të drejtën e të rinjve për të qenë të informuar.

¹ Gazeta zyrtare 101/2019

² McDonagh Maeve, The Right to Information in International Human Rights Law, Human Rights Law Review 13:1, 2013, p. 25-55

³ Council of Europe Convention on Access to Official Documents, CETS No. 205, 2009

⁴ Mund të shihet rasti: Convention of Access to Officials Documents Enters into Force, Newsroom, Council of Europe, December 2020, I qasshëm në <https://www.coe.int/en/web/portal/-/convention-on-access-to-official-documents-enters-into-force#:~:text=Access%20to%20official%20documents%20enables,participation%20in%20decision%20making%20processes.>

⁵ Mund të shihet rasti Ackerman John, M., and Sandoval-Ballesteros Irma E., The Global Explosion of Freedom of Information Laws, Administrative Law Review, 58(1), fq. 85-130, 2006

⁶ United Nations Convention on the Rights of the Child, General Assembly Resolution 44/25, 1989

⁷ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 1/92, 31/98, 91/01,84/03, 107/05, 3/09, 49/11, 6/19, 36/19.

Në vitin 2020, Republika e Maqedonisë së Veriut miratoi Ligj për pjesëmarrje të të rinjve dhe politika rinore⁸, i cili e potencon të drejtën e të rinjve për të qenë të informuar.

E drejta e qasjes në informacione konsiderohet si një parakusht themelor për të drejtën e të rinjve që të marrin pjesë në mënyrë aktive në vendimet që i shqetësojnë ata, duke përfshirë krijimin dhe zbatimin e politikave publike.⁹ Konsiderohet përgjithësisht e pranuar se pa informacion të mjaftueshëm, të rinjtë nuk mund të marrin pjesë në mënyrë të duhur në marrjen e vendimeve dhe politikave që i shqetësojnë ata.

2. Ndërtimi i kulturës së transparencës dhe llogaridhënies

Qasja deri në informacione mbështet transparencën dhe llogaridhënien së bashku me pjesëmarrjen e informuar të publikut në vendimmarrje dhe për këtë arsye paraqet bazë për funksionimin e demokracisë.

Edukimi në këto tema është një parakusht për përfshirjen e të rinjve, d.m.th., informimi i aspekteve të ndryshme të funksionimit të institucioneve ofron një mundësi për angazhim më të madh të të rinjve.

Në vendin tonë ekziston një botëkuptim i përgjithshëm se institucionet mundet, por nuk janë të detyruara të japin llogari para qytetarëve. Konsiderohet se institucionet deklarojnë parimet e llogaridhënies dhe transparencës, por që nuk i referohen çështjeve specifike dhe çështjeve thelbësore. Me publikimin e një raporti të përgjithshëm vjetor në të cilin nuk ka të dhëna për çështje të rëndësishme specifike dhe duke publikuar disa të dhëna të përgjithshme në faqen e internetit të institucionit, konsiderohet se është përmbushur parimi i llogaridhënies. Megjithatë, nëse institucionit i kërkohet ndonjë informacion specifik i rëndësishëm, ai mund të shmangë ta jap atë. Zakonisht niveli i transparencës varet nga vullneti i mirë i institucionit dhe drejtuesve të tij.

Kur institucioneve u kërkohen informacione konkrete, për shembull, në lidhje me një plan urbanistik, personat e punësuar si këshilltarë dhe honoraret e tyre, sa para janë paguar për mobilet apo pikturat etj., institucioni shpesh mendon se "privatësia" e tij po pushtohet" dhe është kundër dhënies së informacionit. Institucionet përgjithësisht konsiderojnë se qytetarët nuk kanë të drejtë t'u kërkojnë atyre informacione të tilla specifike. Ose me fjalë të tjera, ekziston një kulturë e përgjithshme e mostransparencës institucionale. Ligji për Qasje të Lirë deri në Informacionet me Karakter Publik (LQIKP), i cili është lëndë i këtij doracak, thotë të kundërtën. Institucionet janë të detyruara t'u japin informacione qytetarëve kur ata e kërkojnë atë. Institucionet janë gjithashtu të detyruara që të publikojnë vetë informacionin nga fushëveprimi i tyre (zakonisht në ueb faqet e tyre) pa ua kërkuar askush një gjë të tillë. Kjo quhet transparencë proaktive.

Kjo kulturë e jotransparencës është një temë interesante për t'u marrë parasysh. Pyetja kyçe është se pse institucionet sillen në këtë mënyrë? Një argument është se kjo rrjedh nga qëndrimet e njerëzve ndaj pushtetit dhe mënyra se si ata e kuptojnë ushtrimin e pushtetit.

⁸ Gazeta Zyrtare nr. 10/2020

⁹ Young People's Access to Rights through Youth Information and Counseling, Council of Europe, 2015.

Ajo që është më e rëndësishme të theksohet është se kultura mund dhe duhet të ndryshojë. Ajo mund të ndërtohet, të formësohet. Domethënë, institucionet mund të “mësojnë” të sillen në një mënyrë të caktuar, konkretisht, për të rritur transparencën, pra për ta bërë informacionin më të arritshëm në mënyrë proaktive dhe me vetë-iniciativë, si dhe për t’iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve për informim me karakter publik. Në 16 vitet e fundit, që nga zbatimi i rregullores për QLIKIP-në në RMV, ka indikacione për procesin e ndryshimeve dhe gjithësesi se sa i vështirë dhe i ngadalshëm është ai proces.

Institucionet duhet të kuptojnë se në momentin që një qytetar apo organizatë e shoqërisë civile (OSHC) u kërkon atyre informacion të karakterit publik, janë të detyruar t’i japin ato. Institucionet shpesh e japin informacionin pa dëshirë dhe vetëm kur shohin se ka pasoja të mundshme nëse nuk veprojnë sipas LQLIKP-së. Kjo duket nga raportet për punën e Agjencisë për Qasje të Lirë deri në Informacione me Karakter Publik, si dhe nga analizat e ndryshme të bëra nga OSHC-të. Megjithatë, fotografia nuk është aq e thjeshtë. Të gjitha institucionet nuk sillen në të njëjtën mënyrë. Nga raportet e Agjencisë shihet se një pjesë e madhe e institucioneve e respektojnë Ligjin.

Vlen të theksohet se kultura e jotransparencës ka edhe anën tjetër. Kjo mbështetet nga ideja e qytetarëve se nuk duhet të kërkojnë informacione nga institucionet. Një pjesë e madhe e qytetarëve, sidomos të rinjtë, nuk e dinë se e kanë këtë të drejtë. Kjo vetëm pjesërisht është rezultat i mosnjohjes së ligjit. Në një masë të madhe dhe historikisht kjo ndodh për shkak të frikës së institucioneve dhe qeverisë, respektivisht qëndrimi se qytetari nuk duhet ta kundërshtojë pushtetin, por duhet ta dëgjojë dhe t’i nënshtrohet atij. Këto janë dy anët e kulturës së moslogaridhënies.



Argumenti është ky: ndryshimi i kulturës institucionale NUK ËSHTË I LEHTË. Ky është një proces i vështirë dhe gradual. Disa nga institucionet nuk e aplikojnë DQLIKP-në me përkushtim të veçantë, por kjo nuk është për shkak se nuk janë të njohur me të, për më tepër, sigurisht që luan rol edhe njohja e pamjaftueshme e ligjit. Por një pjesë e rëndësishme e moszbatimit të ligjit është për shkak se institucionet nuk duan ta zbatojnë atë, sidomos kur një kërkesë e caktuar për informacion është e pakëndshme për ta.

Bëhet fjalë për një konflikt social mes qytetarit dhe institucioneve qeveritare. Është një konflikt që ekziston në çdo shoqëri dhe në thelb të tij është kontrolli mbi pushtetin në shoqëri. Se kush do të kontrollojë pushtetin.

Në shoqëritë demokratike, pushteti kontrollohet nga qytetarët dhe shpërndahet gjerësisht. Institucionet janë në shërbim të qytetarëve. Në shoqëritë autoritare, pushteti është i përqendruar në duart e një rrethi të vogël njerëzish dhe në raste ekstreme edhe në një udhëheqës suprem (p.sh. Koreja e Veriut sot, si dhe shumë vende të ndryshme gjatë historisë). Në ato shoqëri, institucionet nuk japin llogari para qytetarëve.

Një instrument kyç për ndërtimin e transparencës në institucione si element i rëndësishëm i demokracisë është rregullorja për QLIK-p-në.

Mund të konsiderohet se ligji i ri ka forcuar edhe më tej kapacitetet për ndërtimin e llogaridhënies dhe transparencës në institucione. Ajo që është domosdoshmërisht e nevojshme është promovimi i kulturës qytetare për të kërkuar llogari nga institucionet, apo thënë ndryshe, informimi dhe inkurajimi i qytetarëve për përdorim masiv të Ligjit. Në këtë proces, përfshirja e të rinjve është vendimtare, sepse ata përfaqësojnë pjesën e rëndësishme të popullsisë dhe në përgjithësi janë më të hapur ndaj ndryshimeve sociale dhe mbështetës të qeverisjes së hapur dhe të përgjegjshme.

3. Ligji për Qasje të Lirë deri në Informacionet me Karakter Publik (LQLIKP)

Ligji për qasje të lirë deri në informacione me karakter publik (LQLIKP) u miratua për herë të parë në RMV në vitin 2006. Ligji i ri që është aktualisht në fuqi u miratua në vitin 2019. Ai sollti disa risi të rëndësishme. Për shembull, më parë, organi përgjegjës për zbatimin e ligjit ishte Komisioni. Me ligjin e ri, Komisioni u shndërrua në Agjenci për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik (AQLIKP) ose Agjencia. Afatet për përgjigje nga institucionet nga të cilat kërkohen të dhënat publike janë shkurtuar. Interesi publik u përcaktua saktësisht. Listës së poseduesve të informacionit iu bashkëngjiten edhe partitë politike. Është veçanërisht e rëndësishme që Agjencisë t'i jepet autorizim për të vendosur mbi ankesat. Kur një institucion nuk përgjigjet ose përgjigja nuk është e kënaqshme, kërkuesi i informacionit mund të bëjë një ankesë. Mbi ankesën tani vendos Agjencia.

Agjencia ka një rol kyç në të gjitha aspektet e zbatimit të Ligjit dhe zbatimi i Ligjit është kompetencë thelbësore e saj. Agjencia i përcakton formularët, përpilon dhe përditëson listën e poseduesve të informacionit, vendos mbi ankesat, vendos në procedurat e kundërvajtjes, dhe për shumëçka tjetër.

Një nga obligimet e Agjencisë është promovimi i zbatimit të ligjit. Ky doracak, i cili u drejtohet drejtpërdrejt të rinjve, është një hap në realizimin e kësaj përgjegjësie. Duke promovuar zbatimin e ligjit, Agjencia aktualisht po punon në ndërtimin e një kulture të transparencës dhe forcimin e demokracisë në RMV, si dhe ndërgjegjësimin e të rinjve në parandalimin korrupsionit. Në thelb, ligji është kundër korrupsionit. Është një pjesë thelbësore e rregullores së përgjithshme në vend që synon parandalimin e korrupsionit dhe zvogëlimin e mundësisë ku institucionet bëjnë diçka jashtë kontrollit të qytetarëve.

4. Kush është i obliguar t'i përgjigjet kërkesës për QLIK?

Esenca e ligjit është që çdo person fizik (qytetar) si dhe çdo person juridik (organizatë, ndërmarrje, institucion) ka të drejtë të kërkojë informacion të karakterit publik nga institucionet që e kanë atë informacion. Dhe këto institucione detyrohen t'i përgjigjen kësaj kërkesë.

Bartës të informacionit janë institucionet që janë të detyruara që në mënyrë proaktive të publikojnë informacionin dhe t'i përgjigjen kërkesës për QLIK.

Ligji i definon si bartës të informacionit:

organet e pushtetit shtetëror dhe organet dhe organizatat tjera të përcaktuara me ligj, organet e komunave, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, institucionet dhe shërbimet publike, ndërmarrjet publike, personat juridikë dhe fizikë që ushtrojnë kompetenca publike, të themeluara me ligj dhe aktivitetet e partive politike me interes publik në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve (neni 3, paragrafi 1).

Siç shihet nga definicioni, bëhet fjalë për një numër më të madh të poseduesve të informacionit.

Lista e poseduesve të informacionit hartohet dhe përditësohet nga Agjencia.

Në veçanti, lista në vitin 2022 (kur është shkruar ky manual) përfshin kategoritë e mëposhtme të poseduesve të informacionit:

Institucione shtetërore – 146

Personat juridikë dhe fizikë që ushtrojnë kompetenca publike dhe veprimtari me interes publik - 7310

Ndërmarrje publike dhe institucione – 325

Institucione të veprimtarisë arsimore – 579

Institucione shëndetësore-110

Parti politike– 57


Gjyqësi – 67

Komunat dhe Qendrat për zhvillimit të rajoneve planorë – 88

E gjithë lista e poseduesve gjendet në faqen e internetit të Agjencisë dhe përditësohet rregullisht me informacione.



Grafikoni 1. Lista e poseduesve të informacionit



Burimi: <https://aspi.mk/sq/lista-e-bartesve-te-informacioneve/>

Siç shihet nga uebfaqja e Agjencisë, numri më i madh i bartësve janë nga institucionet arsimore. Shumica e tyre janë shkolla filllore dhe kopshte. Pra çdo qytetar mund të kërkojë informacion të karakterit publik nga çdo shkollë apo kopsht fëmijësh dhe ata janë të detyruar të japë informacion.

Është e evidente se ky është një normativ me një standard të lartë transparence. Ligji i jep të drejtën qytetarit t'i drejtohet çdo institucioni të shtetit, të kërkojë informacion dhe të marrë përgjigje.

Ekzistenca e listës së poseduesve të informacionit dhe përditësimi i rregullt i saj, ka një funksion të rëndësishëm. Ajo përcakton qartë se çka mund të kërkohet dhe kush është i obliguar të japë informacion.


5. Informacioni me karakter publik

Çdo person fizik dhe juridik mund t'u kërkojë poseduesve informacion të karakterit publik. Logjikisht, lind pyetja, çfarë është ajo? Cili është ai informacion që është i karakterit publik? Përgjigjen e jep LQLIKP. Sipas ligjit, informacion publik është:

“informacioni i çfarëdo lloj forme që e ka krijuar ose me të cilën disponon poseduesi i informacionit në përputhje me kompetencat e tij.”

Siç mund të shihet nga përkufizimi i ligjit, informacioni me karakter publik është i përkufizuar shumë gjerësisht. Mund të jetë çdo informacion për punë nga kompetenca e atij institucioni.

Grafikoni 2. Shembull i kërkesës për QLIKP



Burimi: <https://aspi.mk/sq/ankese-deri-tek-agjencioni/>

Për shembull, në kompetencë të institucionit është miratimi i planeve të detajuara urbanistike (PDU). Kjo është një temë jashtëzakonisht aktuale në vend kohëve të fundit, sepse shumë qytetarë janë kundër ndërtimit të tepruar të objekteve të reja në disa komuna. Ndodh shpesh që komunat të justifikohen me argumentin se qytetarët kanë reaguar shumë vonë, pasi ndërtimi ka kaluar tashmë të gjitha fazat për miratim. Në bazë të Ligjit, çdokush mund të kërkojë çdo informacion në lidhje me DUP-të që janë në kompetencë të atij institucioni.

Vitet e fundit ka pasur disa shembuj të vetëorganizimit të qytetarëve në mbrojtje të parqeve dhe zonave të gjelbra që komunat donin t'i kthenin në hapësira për ndërtim të objekteve. Këto protesta udhëhiqeshin rregullisht nga të rinjtë.¹¹

Ose, në kuadër të kompetencave të tij, institucioni ka shpenzuar një shumë të caktuar parash për kontrata në vepër. Mund të kërkohet informacion, për shembull, sa kontrata janë lidhur, për cilat punë/shërbime specifike, për çfarë kohëzgjatje, për cilat shuma dhe me cilët persona. Nga raportet e Agjencisë shihet se një informacion i tillë kërkohej në bazë të LQLIKP -së. Informacionet për temat që janë të rëndësishme për jetën e të rinjve, dhe njëkohësisht janë informacione të karakterit publik, janë të shumta.

¹¹ Mund të shihet për shembull: Kampi i "Mbrojtësve të parkut" në mbrojtje të "Parkut Gruevski", A1on, gusht 2013, do e gjeni në <https://a1on.mk/macedonia/parkobranite-kampuvaat-vo-odbran/>, Në mbrojtje të Debar Maalos: Një park, jo 60-katësh në parkingun përballë Holiday Inn, Mkd.mk, Nëntor 2018, në dispozicion në <https://www.mkd.mk/makedonija/skopje/vo-odbrana-na-debar-maalo-park-a-ne-60-katnici-na-parkingot-pred-holidej-in>, Iniciativa qytetare për mbrojtjen e një parku në Shtip, Radio MOF, Nëntor 2015, do e gjeni në <https://www.radiomof.mk/gragjanska-inicijativa-za-odbrana-na-park-vo-shtip/>, Banorët e Taftalixhes do të kërkojnë një referendum lokal për të mbrojtur parkun, Nova TV, gusht 2016, do e gjeni në <https://novatv.mk/zhitelite-na-taftalidhe-ke-baraat-mesen-referendum-za-odbrana-na-parkot/>

Një informacion i tillë ndonjëherë i referohet një grupi të caktuar ose një brezi të tërë të rinjsh. Për shembull:

- Si janë blerë tekstat shkollorë për arsimin e mesëm dhe fillor dhe sa janë paguar;
- Si bëhet organizimi dhe pagesa e ekskursioneve të nxënësve;
- Nën çfarë kushtesh jepet në shfrytëzim salla e shkollës dhe për çfarë përdoren ato mjete?
- Informacion për procedurat e punës të shkollave dhe fakulteteve;
- Sa para ndan komuna për financimin e projekteve rinore?

5.1 Çfarë mund të kërkohet si informacion?

LQLIKP ofron mundësinë për të kërkuar informacionin në çdo format të disponueshëm. Ligji thotë se një dokument është "çdo regjistrim informacioni pavarësisht nga forma ose karakteristikat e tij fizike, tekst i shkruar ose i shtypur, harta, skema, fotografi, pamje, vizatime, skica, materiale të punës, si dhe incizime optike ose video zëri, akustike, magnetike apo elektronike në çdo formë, si dhe pajisje portative ose mobile për përpunimin automatik të të dhënave me memorie të integruara për ruajtjen e të dhënave në formë dixhitale".

Me pak fjalë, informacioni mund të kërkohet në çdo format në të cilin është i disponueshëm. Është e rëndësishme të theksohet se kërkuesi mund të kërkojë gjithashtu edhe këqyrje në informacione të caktuara. Kjo do të thotë që ai mund të kërkojë të vijë në ambientet e pronarit dhe të shikojë drejtpërdrejt një regjistër, PDU, dosje etj.

Të gjitha informacionet që kanë ndodhur gjatë ose në lidhje me punën e shkollave, fakulteteve ose universiteteve, të cilat janë të regjistruara në një dokument specifik - rregullore, dispozitë, procesverbale, raporte, janë informacione që nxënësit apo studentët kanë të drejtë t'i kërkojnë dhe t'i dinë. Në të njëjtën kohë, siç u përmend tashmë, institucionet kanë obligim për transparencë proaktive. Kjo do të thotë që ata vetë duhet të publikojnë informacione të rëndësishme për punën e tyre, pa ua kërkuar askush një gjë të tillë. Kjo zakonisht bëhet duke e publikuar informacionin në faqet e tyre të internetit.

5.2 Prej kujt kërkohet informacioni?


Sipas ligjit, çdo posedues i informacionit është i obliguar të caktojë një person zyrtar.

Ai/ajo është punonjës/e i atij institucioni. Kërkesa parashtrohet deri te ky person zyrtar. Ai/ajo është i detyruar të sigurojë informacionin nga departamenti në institucionin që e posedon atë informacion dhe t'ia japë kërkuesit brenda afatit ligjor.

Ata persona zyrtarë mbajnë edhe përgjegjësinë nëse institucioni nuk vepron sipas kërkesës. Në praktikë, komentohet se kufizimi i përgjegjësisë për mosdhënien e informacionit vetëm tek personi zyrtar është i pamjaftueshëm, pasi ai as që mund t'ia japë atë kërkuesit nëse nuk arrin ta marrë atë nga pjesa tjetër e institucionit që e posedon atë. Kjo e vë personin zyrtar në pozitë të palakmueshme. Në këtë kuptim, janë të logjikshme komentet se përgjegjësia kryesore duhet të jetë tek udhëheqësi i institucionit.

Njëkohësisht, është e qartë se dënimet janë relativisht të ulëta nëse krahasohen me një numër të madh veprash të tjera që mbrojnë një interes publik dukshëm më të vogël. Është evidente tendenca që ligjvënësi të përcaktojë dënime më të ulëta kur ato janë të orientuara drejt sektorit publik.

Grafiku 3. Lista e poseduesve. Kontakti i personit zyrtar



Emërimi i personit zyrtar dhe detyrimi që kontakti i këtij personi të shfaqet në faqen e internetit të poseduesit, ka një funksion vërtet domethënës. Kjo parandalon fenomenin e njohur të labirintit, pra përcjelljen nga një person te tjetri brenda të njëjtit institucion që supozohet se është kompetent.

Shfletimi i listës së poseduesve të informacionit, me vetëm disa klikime çon drejtpërdrejt te personi zyrtar kompetent për t'iu përgjigjur kërkesës.

5.3 Përrjashtime nga DQLIKP

Është logjike që ndonjëherë publikimi i disa të dhënave mund t'i shkaktojë dëm dikujt, por mund të dëmtojë edhe interesin publik. Për shembull, nëse publikohen informacionet personale të dikujt, kjo mund t'i shkaktojë dëm personit konkret. Disa të dhëna janë konfidenciale në bazë të ligjeve të tjera. Informacionet që janë pjesë e një hetimi penal, një procedimi penal ose të një procedim tjetër mund të shkaktojnë gjithashtu dëm nëse publikohen.

Për këto arsye, poseduesi i informacionit mund të refuzojë plotësisht ose pjesërisht t'i japë kërkuarit informacionin e kërkuar nëse ka arsye që e justifikojnë këtë. Kjo mund të jetë vetëm me përjashtim nga rregulli i përgjithshëm.

Ligji i rregullon këto përjashtime në nenin 6. Kjo dispozitë e ligjit parashikon pesë kategori përjashtimesh:

- 1) nëse informacioni i kërkuar është i klasifikuar në bazë të një ligji tjetër,
- 2) nëse bëhet fjalë për të dhëna personale, publikimi i të cilave nuk lejohet,
- 3) nëse informacioni i publikuar do të dëmtonte konfidencialitetin e fletëparaqitjes tatimore,
- 4) informacione lidhur me hetimet, procedimet penale, kundërvajtëse, civile etj,
- 5) informacion në lidhje me të drejtat e pronësisë industriale ose intelektuale (p.sh. patentë), të mbrojtura në përputhje me ligjin

Kur një kërkesë përmban disa nga këto kategori informacioni, poseduesi mund të refuzojë ta japë atë informacion, duke iu referuar disave nga këto baza.

Mirëpo edhe në atë rast pronari nuk mund ta refuzojë kërkesën drejtpërdrejt, por vetëm pasi të bëjë të ashtuquajturin test të dëmit.

Sipas ligjit, testi i dëmit është "procedurë e obligueshme e kryer nga poseduesi i informacionit, para se ta refuzojë qasjen në përputhje me nenin 6 paragrafi (1) të këtij ligji, e me të cilin verifikohen pasojat mbi interesin që mbrohet, respektivisht interesin publik që do të arrihej me publikimin e informacionit."

Kjo do të thotë se institucioni duhet të vlerësojë se çfarë është më e rëndësishme në rastin konkret: interesi që mbrohet nga mospublikimi i informacionit, apo interesi publik që do të arrihej me publikimin e tij. Njëherit, ligji përcakton saktësisht se çfarë nënkuptohet me interes publik në këtë kontekst (shih pjesën më poshtë).

Duket qartë se kjo nuk është një punë e lehtë. Për këtë arsye, Agjencia ka bërë një doracak të veçantë Doracak për kryerjen e testi të dëmit i cili duhet t'i udhëzojë poseduesit në zbatimin e kësaj procedure.

Në raportin e saj të vitit 2021, Agjencia vë në dukje se disa institucione vetëm formalisht u referohen përjashtimeve nga neni 6 dhe testit të dëmi, sa për të justifikuar refuzimin e dhënies së informacionit, edhe pse ata në të fakt nuk kanë bërë një analizë reale të dëmit. Me fjalë të tjera, disa institucione e shfrytëzojnë këtë si e ashtuquajtura "vrimë në ligj".

Kjo nuk do të thotë që ajo "vrimë" duhet të mbyllet duke u shfuqizuar ai nen i ligjit. Është e qartë se kjo nuk është e mundur. Përjashtimet duhet të ekzistojnë. Megjithatë, Agjencia përpiqet të kontrollojë se si institucionet i shfrytëzojnë përjashtimet dhe të parandalojë abuzimet.

Si përfundim, ajo që në thelb duhet mbajtur mend është se poseduesi mund të refuzojë të japë informacion vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe vetëm pasi të ketë vlerësuar arsyet për dhe kundër publikimit.

5.4 Çka është interesi publik?

Koncepti i interesit publik nënkupton se në shoqëri ka interesa të përgjithshme ose të përbashkëta të cilat janë më të rëndësishme se e drejta individuale ose grupore e secilit. Shumë nga ato interesa publike janë të përcaktuara në mënyrë eksplicite nga aktet më të larta juridike të shteteve, kushtetutat, si dhe nga shumë ligje të veçanta. Për shembull, secili duhet të thithë ajër të pastër dhe të pijë ujë të pastër. Në këtë kuptim, ajri i pastër dhe uji i pijshëm janë me interes të veçantë publik dhe përgjithësisht konsiderohen si të drejta të njeriut.

Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se interesi privat i një fabrike për të nxjerrë tym helmues, pa vendosur filtër të shtrenjtë që mund të kushtojë miliona euro, nuk mund të jetë më i rëndësishëm se interesi publik. Është evidente përplasja mes interesit privat të kompanisë (të kursejë disa milionë euro) dhe interesit publik që qytetarët të thithin ajër të pastër.



Ja një shembull tjetër që shihet çdo ditë në praktikë në rrugët tona. Çdo këmbësor ka të drejtë të ketë mundësi të lëvizë i sigurt në qytet. Për këtë nevojitet të kemi një trotuar të sigurt. Megjithatë, shumë shoferë parkojnë aty ku e kanë më lehtë dhe më shpejtë, përfshirë këtu edhe në trotuare. Kështu, shumë nga trotuaret në qytetet e Maqedonisë së Veriut janë të bllokuara nga automjetet, kështu që këmbësorët, madje edhe nënat me foshnja në karroca, janë të detyruar të ecin në rrugë. Në disa komuna këmbësorët janë më të sigurt sepse trotuaret mbrohen me gardhe (sepse institucionet lokale kanë qenë më efikase), e në disa nuk janë. Ky është një shembull tipik i konfliktit të interesave dhe të drejtave, të cilat mund të shihen si individuale, grupore dhe sigurisht edhe në tërësinë e tyre, si interesa publike. Në pamje të parë, ky shembull mund të duket i lehtë për t'u zgjidhur, ose banal. Dhe në nivelin e parimit ai është i zgjidhur; në praktikë ndodh si pasojë e joefikasitetit institucional. Megjithatë, rastet e përditshme të këmbësorëve të goditur dhe dhunës (si rrjedhojë e stresit të vazhdueshëm të pjesëmarrësve) në trafik, veçanërisht në kryeqytet, vë në dukje se ky është një problem serioz.

Është evidente se koncepti i interesit publik është shumë kompleks dhe se ekziston nevoja e vazhdueshme për të analizuar dhe matur rëndësinë dhe përparësinë e interesave të caktuara në shoqëri.

Çdo shoqëri është në një proces i vazhdueshëm vlerësimi dhe ndërmjetësimi midis interesave të shumta. Institucionet publike kanë një rol jetik në këto procese.

Është evidente se koncepti i interesit publik është shumë kompleks dhe se ekziston nevoja e vazhdueshme për të analizuar dhe matur rëndësinë dhe përparësinë e interesave të caktuara në shoqëri.

Çdo shoqëri është në një proces i vazhdueshëm vlerësimi dhe ndërmjetësimi midis interesave të shumta. Institucionet publike kanë një rol jetik në këto procese.

Ligji përcakton shprehimisht se çfarë nënkuptojmë me interes publik që duhet të merret parasysh nga poseduesit e informacionit. Duhet theksuar se kjo është një risi e aprovuar legjislativin e vitit 2019. Sipas ligjit (neni 3):

“interesi publik në ushtrimin e së drejtës për qasje në informacion nënkupton, por nuk kufizohet në interesin për informacionin, me publikimin e të cilit, respektivisht realizimin e qasjes:

- 1) do të zbulohet keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe sjelljet korruptive;
- 2) do të zbulohet blerja ose shpenzimi i paligjshëm i mjeteve buxhetore;
- 3) do të zbulohet një konflikt i mundshëm interesi;
- 4) do të parandalohen dhe zbulohen kërcënimet serioze për shëndetin dhe jetën e njerëzve;
- 5) do të parandalohen dhe zbulohen kërcënimet ndaj mjedisit;
- 6) do të ndihmojë për të kuptuar çështjen për të cilën krijohet politika publike apo zhvillohet debat parlamentar dhe
- 7) do të mundësohet trajtim i barabartë i çdo qytetari para ligjeve.“

Ligji i parashikon këto shtatë baza të cilat janë të renditura në nenin 3, por gjithashtu thekson se interesi publik nuk kufizohet vetëm në këto baza. Kjo do të thotë se duhet të merren parasysh edhe interesa të tjera publike që mund të lindin në raste specifike, kundrejt të cilave duhet të analizohet vendimi për dhënie ose mosdhënie e informacionit të kërkuar.

5.5 Obligimi për publikim të informacioneve

Institucionet janë të obliguara rregullisht të publikojnë informacione për punën e vet në ueb faqet e tyre.

Ligji (neni 10) përmban një listë më të gjatë të informacioneve që institucionet janë të detyruara t'i publikojnë pa i pyetur askush. Kjo i përfshin, për shembull, dispozitat që i sjell institucioni, planet strategjike, buxhetin, llojet e shërbimeve që i kryen institucioni, etj. Në të njëjtën kohë, institucionet janë të detyruara t'i shënojnë në faqet e tyre të internetit kontaktet e zyrtarëve të tyre përgjegjës për kërkesat për QLIKP.

Ky publikim i sa më shumë informacioneve që është e mundur, quhet transparencë proaktive. Ideja është që sa më shumë të publikojë vetë institucioni, pa ia kërkuar askush këtë, aq më shumë zvogëlohet nevoja për parashtrim të kërkesa për QLIKP.

6. Si të parashtroni kërkesë për një QLIK?

Kërkesa për QLIK mund të parashtrohet në çfarëdo mënyre, qoftë edhe gojarisht. Me këtë, ligji jep mundësi të kërkojnë informacion madje edhe personat që nuk mund të plotësojnë një formular me shkrim apo në mënyrë elektronike. Ligji rregullon se si duhet të veprojë institucioni kur i parashtrohet një kërkesë gojarisht.

Gjithësesi, mënyrat e zakonshme për të paraqitur një kërkesë për QLIK janë plotësimi i një kërkesë me shkrim ose në mënyrë elektronike.

Faqja e internetit e Agjencisë ka një Portal shtesë për Aplikantët, deri te i cili mund të arrihet përmes adresës www.slobodenpristap.mk.

Paraqitja e një kërkesë është shumë e thjeshtë. Në vetëm disa hapa të thjeshtë, bëhet regjistrimi i përdoruesit, më pas përdoruesi zgjedh institucionin të cilit i paraqet kërkesën dhe shkruan një pyetje të shkurtër dhe të qartë.

Siç mund shihet, pas plotësimit të kërkesës, përdoruesi mund ta shpërndajë menjëherë në Twitter, Facebook etj., gjë që mund të rrisë më tej dukshmërinë e kërkesës dhe të animojë opinionin publik.

Në parim, Agjencia e ka bërë parashtrimin r kërkesës tejet të shpejtë dhe të lehtë. Kjo përsëri është në favor të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve. Sa më e lehtë është të parashtrohet kërkesa, aq më shpesh qytetarët do parashtrajnë. Gjithësesi, një formular dhe një procedurë e ndërlikuar do të çonin në shumë më pak kërkesa.

Është e rëndësishme të theksohet se aplikanti nuk është i detyruar të arsyetojë kërkesën. Mjafton të thuhet se është një kërkesë për QLIK. Kjo, në fakt, do të thotë se ligji e vendos qytetarin në një pozitë superiore në raport me institucionin. Kjo është në kundërshtim me një situatë në të cilën qytetari pritët t'i lutet institucionit dhe të arsyetojë, në mënyrë që ai të vlerësojë nëse do të miratojë diçka. Ligji e vendos qytetarin në pozitën e një pretenduesi, të cilit institucioni është i detyruar t'i përgjigjet.

Që nga momenti i paraqitjes së kërkesës, poseduesi i informacionit duhet menjëherë më së voni në një afat ligjor prej 20 ditësh (i cili mund të zgjatet deri në 30 ditë) të përgjigjet.


6.1 Çka nëse poseduesi nuk i përgjigjet kërkesës?

Poseduesi mund ta hedhë poshtë kërkesën (sepse nuk ka qenë në formën e kërkuar ose e pakompletuar), ta refuzojë kërkesën tërësisht ose pjesërisht. Gjithashtu, poseduesi mund të mos i përgjigjet fare kërkesës, domethënë ta injorojë atë. Kjo është situata që më së shpeshti ndodh në praktikë, kur poseduesi nuk i përgjigjet kërkesës. Quhet “heshtje e administratës”.

Në të gjitha këto raste, aplikanti mund të paraqesë ankesë në Agjenci. Parashtruesi i kërkesës e paraqet ankesën në Agjenci dhe ajo është e detyruar të vendosë mbi ankesën në afat prej 15 ditësh. Nëse Agjencia nuk vendos mbi ankesën brenda afatit, kërkuesi ka të drejtë të iniciojë një kontest administrativ në Gjykatën Administrative.

Parashtrimi i ankese është shumë i thjeshtë. Formulari i ankësës është përpiluar nga Agjencia dhe është postuar në ueb faqen e saj (Grafikoni 4. më poshtë). Mjafton që ankuesi të japë një përshkrim të shkurtër se mbi cilën bazë ankohet.

Grafikoni. 4 Udhëzime dhe formulari për ankesë



7. Konkluzione

Qëllimi i këtij doracak është të afrojë LQLIKP-në me të rinjtë. Sa më shumë të rinjtë ta njohin këtë ligj dhe ta shfrytëzojnë atë, aq më shumë do të kontribuojnë në llogaridhënien e institucioneve dhe cilësinë e proceseve demokratike në Maqedoninë e Veriut.

Është e qartë se Ligji është një mjet i fuqishëm në duart e të rinjve, qytetarëve, mediave, OSHC-ve si dhe subjekteve të tjera, për monitorimin e punës së institucioneve. Nga raportet e Agjencisë shihet se në periudhën e kaluar përfitues më të mëdhenj të këtij ligji kanë qenë OSHC-të.

Të dhënat nga raporti i Agjencisë për vitin 2021 tregojnë se Ligji po zbatohet. Por ata tërheqin vërejtjen gjithashtu se një pjesë reale e poseduesve të informacioneve nuk e respektojnë sa duhet ligjin.

Formularët dhe procedura për paraqitjen e kërkesës për QLIKIP janë jashtëzakonisht të thjeshta, gjë që kontribuon në zbatimin efikas të tij.

Shumë të rinj dhe qytetarë në RMV nuk janë të informuar se mund të monitorojnë punën e institucioneve në mënyrë kaq të lehtë dhe të thjeshtë.

Është e nevojshme që Ligji të promovohet sa më gjerësisht në mënyrë që të ndërtohet vazhdimisht kultura e llogaridhënies dhe transparencës. Ky doracak kontribuon drejt këtij qëllimi.



8. Program trajnimi me të rinjtë për të njohur dhe për të shfrytëzuar DQLIKP-në

8.1 Moduli **1**

Tema:

Transparenca dhe demokracia

Sesioni 1:

Diskutim plenar me të komplet grupin e pjesëmarrësve. Diskutohen konceptet si transparenca, aktivizmi qytetar, demokracia,

Pyetje:

Pse disa vende janë demokraci dhe disa jo? Çfarë lloj shtetesh mund të kemi mbi këtë bazë? Cilat shtete jodemokratike i njihni? Si janë bërë të tilla?

Cili është ndryshimi midis institucioneve në shoqëritë demokratike dhe jodemokratike? A është një vend demokraci sepse është i pasur apo është pasuruar sepse ka qenë demokraci?

A mund të zhvillohet demokracia duke shkruar ligje?

Sa varet nga qytetarët lloji i rendit shoqëror?

Pse ka pasur më pak demokraci në histori se sot?



8.2 Moduli **2**

Tema: Interesi publik

Sesioni 1:

Puna në grupe të vogla. Pjesëmarrësit ndahen në 4-6 grupe më të vogla (në varësi të madhësisë së të gjithë grupit). Secili grup duhet të survejojë në Internet dhe të shpjegojë konceptin e interesit publik. Atyre u jepen 15 minuta për hulumtim dhe diskutim në grup, më pas secili grup prezanton.

Sesioni 2:

Loja e roleve. Pjesëmarrësit ndahen në skuadra. Parashtrohet një pyetje. Njëra skuadër e mbron argumentin, ndërsa tjetra e sulmon atë (ideja është të përfaqësohen palët kundërshtarë në një konflikt shoqëror të interesit). Çdo skuadër ka p.sh. 20 minuta kohë për përparatje dhe më pas 5 minuta për prezantim pas çka vijon debati. Publiku mund të komentojë. Është e rëndësishme që pyetjet të zgjidhen në mënyrë të tillë që të nxisin debat.

Shembuj të pyetjeve të mundshme në debat:

Të rinjtë duhet të kenë të drejtën e votës që nga moshë 16 vjeçare (pro/kundër). Media mund të publikojë edhe informacione të pa verifikuara nëse është në interes të publikut (për/kundër)

Dënimet për kundërvajtje për personat zyrtarë të poseduesit e informacioneve janë tepër të ulëta (pro/kundër).

Nuk është e justifikueshme nga pikëpamja sociale që personi zyrtar të poseduesit i informacionit të duhet të harxhojë 3 ditë pune për t'i dhënë informacion një kërkuesi. Pa kufizime, institucionet gjatë gjithë kohës vetëm do të tu përgjigjen kërkesave (pro/kundër).

Sesioni 2a: Pasi të prezantohet loja dhe pjesëmarrësit të kuptojnë parimin, ata mund të përfshihen në procesin e krijimit të një pyetjeje debati. Ata ndahen në grupe të vogla dhe secilit grup i kërkohet të parashtrorë disa pyetje që mund të jenë lëndë e një loje me role. Më pas merren parasysh të gjitha pyetjet e propozuara dhe zgjidhen ato më të përshtatshmet. Pyetjet duhet të lidhen me DQLIKP. Duhet të kemi parasysh se ushtrimi kërkon kohë të konsiderueshme dhe se mund të bëhet më gjatë vetëm nëse i gjithë trajnimi është më i gjatë (p.sh. më shumë se 1 ditë.)



8.3 Moduli 3

Tema:

Pyetje të mundshme me interes për të cilat mund të parashtrohet kërkesë

Sesioni 1.

Pjesëmarrësit ndahen në grupe të vogla. Secili grup bën shqyrtimin e artikujve të medias në periudhën e kaluar dhe shqyrton pyetjet e mundshme me interes publik për të cilat mund të paraqiten kërkesa. Në të njëjtën kohë, përcakton gjithashtu se cili posedues do të ishte kompetent për t'iu përgjigjur pyetjes. Mund të jepen rreth 40 minuta për shqyrtim të medias në mënyrë që të ketë një diskutim brenda grupeve të vogla. Kjo pasohet nga prezantimet. Prezantimet bëhen si në vijim. Së pari, të gjitha grupet paraqesin pyetjen e parë, e ndjekur nga një diskutim. Pastaj shkon me një raund tjetër prezantimesh për pyetjen e dytë, etj. në varësi të kohës në dispozicion. Ushtrimi kërkon të paktën 1.5-2 orë për tu zbatuar.

Sesioni 2.

Pjesëmarrësit ndahen në grupe të vogla. Secili grup shqyrton listën e poseduesve dhe mendon për pyetje të mundshme me interes. Me këtë rast, fokusi mund të jetë te poseduesit më pak të dukshëm (jo institucionet kryesore shtetërore dhe komunat). Në kuadër të ushtrimit, pjesëmarrësit duhet të kërkojnë edhe informacione për kompetencat e poseduesve, në mënyrë që të mund të mendojnë për çështje që janë brenda fushës së këtyre kompetencave. Rreth 40 minuta për punë në grupe, pasçka vijojnë ciklet e prezantimeve.

8.4 Modul 4

Tema:

Kërkesat e disponueshme në Portalin e kërkuësve

Sesioni 1.

Pjesëmarrësit ndahen në grupe të vogla. Secili grup shqyrton dhe mendon për kërkesat që janë në portal.

Sesioni 2.

Vazhdon puna nga Moduli 3. Shënohen (për shembull) 10 kërkesat më interesante në tabelë. Votohet me qëllim që të zgjidhen 4 me më shumë vota. Përsëri votohet që nga ato 4 të zgjidhen 2. Votohet përsëri për të zgjedhur 1 pyetje më interesante që mund të parashtrohet. Në hapin e radhës, grupi e parashtron kërkesën. Përzgjidhet një pjesëmarrës i cili regjistron një profil dhe e parashtron kërkesën (nën mbikëqyrje dhe me mbështetjen e një nëpunësi të Agjencisë).

9. Referenca

Ackerman John, M., and Sandoval-Ballesteros Irma E., The Global Explosion of Freedom of Information Laws, *Administrative Law Review*, 58(1), p. 85-130, 2006

Convention of Access to Officials Documents Enters into Force, Newsroom, Council of Europe, December 2020

Council of Europe Convention on Access to Official Documents, CETS No. 205, 2009

McDonagh Maeve, The Right to Information in International Human Rights Law, *Human Rights Law Review* 13:1, 2013, p. 25-55

United Nations Convention on the Rights of the Child, General Assembly Resolution 44/25, 1989

Young People's Access to Rights through Youth Information and Counseling, Council of Europe, 2015

Në mbrojtje të Dibrës Maalo: Park, jo 60 katësh në parkingun përballë Holiday Inn, Mkd.mk, Nëntor 2018

Iniciativa qytetare për mbrojtjen e parkut në Shtip, Radio MOF, Nëntor 2015

Banorët e Taftalixhes do të kërkojnë një referendum vendor për të mbrojtur parkun, Nova TV, gusht 2016

Ligji për pjesëmarrje të rinisë dhe politikën rinore, *Gazeta Zyrtare* 10/2020

Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik, *Gazeta Zyrtare* 101/2019

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Gazeta Zyrtare e RSM* 1/92, 31/98, 91/01, 84/03, 107/05, 3/09, 49/11, 6/19, 36/19

“Mbrojtësit e parkut” po bëjnë kampe në mbrojtje të “Parkut Gruevski”, A1on, Gusht 2013